

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE
QË LIDHEN ME
AGJENCINË KOSOVARE
TË PRIVATIZIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF
KOSOVO ON KOSOVO
PRIVATIZATION AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU AGENCIJU
ZA PRIVATIZACIJU

ASC-10-0083

~~XXXXXXXXXX~~

Paditësi/Apeluesi

Person fizik, Gjakovë

I përfaqësuar nga Afrim Radoniqi, Gjakovë

kundër

Agjencia Kosovare e Privatizimit,

I Padituri/Apeluesi

Ilir Konushevci 8, Prishtinë

Teki Bokshi, Avokat

Rr. Nëna Terezë Nr.175d, Gjakovë

Palë e interesuar

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues, Piero Leanza, Esmat Erterzi, Ondrej Pridal dhe Behxhet Muqiqi, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 5 korrik 2012, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Ankesat e Ankusve ~~XXXXXXXXXX~~ dhe AKP-së refuzohen si të pabazuara.**
- 2. Vërtetohet aktgjykimi i Trupit Gjykses të DHPGJS-së, i datës 8 shtator 2010, SCEL-09-0012.**
- 3. Procedura ankimore lirohet nga taksat gjyqësore.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Më 8 shtator 2010, Trupi Gjykses i DHPGJS-së i pranoi si të bazuara ankesat e ~~Enxhijit Padituri~~ dhe ~~Enxhijit Padituri~~ të paraqitura kundër listës përfundimtare të punëtorëve me të drejtë legjitime për të fituar një pjesë nga 20% e të ardhurave nga privatizimi të publikuar nga AKP-ja dhe obligoi AKP-në që ti përfshijë në listën përfundimtare, ndërsa ankesën e ankuesit ~~Enxhijit Padituri~~ e refuzoi si të pabazuar.

Trupi Gjykses në aktgjykimin e ankimuar erdhi në përfundim se Ankuesit ~~Enxhijit Padituri~~ dhe ~~Enxhijit Padituri~~ ishin diskriminuar, dhe për këtë arsye ata i kanë plotësuar kushtet ligjore që të jenë në listë, në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar, ndërsa i Padituri nuk kishte arritur të sjellë dëshmi për të kundërtën, siç kërkohet me nenin 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit Nr. 2004/3.

Trupi Gjykses e refuzoi ankesën e ~~Enxhijit Padituri~~ si të pa bazuar për arsye se marrëdhënia e tij e punës kishte përfunduar në vitin 1997 dhe se në kohën e privatizimit të NSH-së ai nuk ishte në listën e pagave, prandaj nuk i kishte plotësuar kushtet ligjore që të jetë në listë.

Më 1 nëntor 2010, **Ankuesi/Apeluesi** ~~Enxhijit Padituri~~ (tani e tutje **"Apeluesi 1"**), parashtrio ankesë kundër aktgjykimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së, ku kërkoi nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së që ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta vendosë në mënyrë meritore. Për më tepër, Apeluesi 1 në ankesë pretendon se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, gabimisht është aplikuar e drejta materiale dhe janë shkelur dispozitat procedurale. Ai më tej pretendon se është shkelur parimi i barazisë në mes palëve pasi që ankesat e ~~Enxhijit Padituri~~ dhe ~~Enxhijit Padituri~~ janë aprovuar pa bazë ligjore, pa u vërtetuar diskriminimi i supozuar i tyre, ndërsa ankesa e tij është refuzuar në bazë të deklaratave të dëshmitarëve. Apeluesi 1 pretendon se pas luftës së bashku me drejtorin dhe të tjerët ka qenë në punë në NSH, ku ka bërë regjistrimin dhe është kujdesur për asetet e NSH-së, megjithatë ky fakt nuk

është marrë parasysh nga Trupi gjykues. Ai argumentoi se ky është dashur të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime.

Më 4 nëntor 2010, **I Padituri/Apeluesi**, Agjencia Kosovare e Privatizimit (tani e tutje "**Apeluesi 2**") gjithashtu parashtroi ankesë ndaj aktgjyqimit në fjalë të Trupit Gjykues dhe kërkoi nga Kolegji i Ankesave që ta aprovojë ankesën dhe ta anulojë aktgjykimin e shkallës së parë.

Apeluesi 2 pretendon se është vërtetuar gabimisht gjendja faktike dhe është aplikuar gabimisht e drejta materiale. AKP-ja pohon se Trupi Gjykues kishte qasje të gabuar në interpretimin e nocionit të diskriminimit me supozimin se i Padituri është duhur të sjellë kundër argumente për diskriminimin e supozuar, prandaj Apeluesi 2 konsideron se nuk ishte vërtetuar drejtë gjendja faktike rreth diskriminimit të supozuar të ankuesve ~~Megjithatë~~ ~~Dedebaj~~ dhe ~~Et'hem Beut~~.

Më 8 nëntor 2010 Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së kërkoi nga Apeluesi 1 që të dorëzojë kopjen e aktgjyqimit të ankimuar dhe të deklarojë datën e pranimit të aktgjyqimit të ankimuar. Apeluesi 1 iu përgjigj urdhrin të Kolegjit të Ankesave më 10 nëntor 2010, duke bashkangjitur parashtresës së tij aktgjykimin e ankimuar dhe duke deklaruar se e ka pranuar atë më 8 nëntor 2010.

Më 23 shkurt 2011 Kolegji i Ankesave lëshoi një urdhër për dërgimin e ankesës së Apeluesit 1 tek Apeluesi 2. Apeluesi 2 konfirmoi pranimin e urdhrin dhe të ankesës së Apeluesit 1 më 7 mars 2011, por nuk dha ndonjë përgjigje në këtë ankesë.

Më 15 shtator 2011 Kolegji i Ankesave lëshoi një urdhër për dërgimin e ankesës së Apeluesit 2 tek Apeluesi 1. Ky urdhër u pranua më 16 shtator 2011 nga Apeluesi 1, megjithatë ai nuk dha ndonjë përgjigje në këtë ankesë.

Më 31 janar 2011, pala e interesuar - i autorizuari i ~~Megjithatë~~ ~~Dedebaj~~ dhe ~~Et'hem Beut~~ avokati Teki Bokshi, ushtroi parashtresë në të cilën kërkoi nga Kolegji i Ankesave që të vendosë sa më shpejtë lidhur me ankesat e paraqitura ndaj aktgjyqimit të ankimuar të Trupit Gjykues.

Arsyetimi ligjor:

Ligji Nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji mbi Dhomën e Posaçme) hyri në fuqi më 1 janar 2012. Jo vetëm që ishte lëshuar aktgjykimi i ankimuar por edhe ankesat ishin ushtruar në kohën kur në fuqi ishte RREG UNMIK-ut 2008/4. Të gjitha veprimet për sa i përket procedurës ankimore ishin bërë sipas Rregullores së Dhomës së Posaçme. Më 1.1.2012, procedura në ankesë ishte në nivel të avancuar. Për më tepër, gjykimi i duhur i lëndës kërkon që në lëndën në fjalë të zbatohen Rregullorja e Dhomës së Posaçme dhe aktet nënligjore që dalin nga ajo.

Ankesat janë të pranueshme por të pabazuara. Në bazë të nenit 63.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Kolegji i Ankesave ka vendosur që të mos vazhdoj me pjesën gojore të procedurës gjyqësore.

Nenet 10.4 dhe 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 i përcaktojnë kërkesat që një punëtor të konsiderohet legjitim për të pranuar një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së. Neni 10.4 e parasheh qartë se punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite. Megjithatë, kjo kërkesë nuk e ndalon përfshirjen në listë të një punëtori i cili pretendon se do të ishte legjitim për listën nëse nuk do të ishte diskriminuar.

Në anën tjetër, Ligji Kundër Diskriminimit, i cili i mbizotëron të gjitha ligjet e aplikueshme më parë në këtë fushë, përcakton se *"kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë"*.

Prandaj, kur ish punëtorët të cilët dëshmojnë marrëdhënien e tyre të punës në NSH dhe pretendojnë diskriminimin paraqesin fakte nga të cilat mund të supozohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në lidhje me përfundimin e marrëdhënies së tyre të punës, barra e provës i kalon të Paditurit.

Megjithatë, ata të cilën e humbën mundësinë që të jenë punëtorë në kohën e privatizimit për së paku tri vite për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke u pensionuar më parë qoftë për shkak të moshës apo invaliditetit apo që vdiqën në rrethana të cilat nuk kanë të bëjnë fare me luftën nuk do të konsiderohen si legjitim pasi që ata nuk do të kishin plotësuar kushtet e të qenit punëtor në kohën e privatizimit edhe nëse nuk do të ishin diskriminuar.

Duke marrë parasysh arsyet e lartpërmendura, Kolegji i Ankesave vjen në përfundim si më poshtë sa i përket meritave të të dyja ankesave.

Meritat e ankesës së Apeluesit 1

Trupi Gjykses me pikën 1 të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar kishte vendosur që të pranojë ankesat e Ankuesve ~~Mustafa Paditurić~~ dhe ~~Alban Dibrari~~ si të bazuara dhe kishte obliguar të Paditurin AKP që këta ankues ti përfshijë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime.

Apeluesi 2 pretendoi se ankuesit që janë përfshirë nga Trupi Gjykses në listën e punëtorëve me të drejta legjitime nuk kanë dëshmuar me ndonjë provë (përveç librezës së punës që kishte mbetur e hapur) se pas qershorit të vitit 1999 ata kishin vazhduar marrëdhënien e tyre të punës. Kolegji i Ankesave vëren në lidhje me këtë se Ankuesit nuk pretenduar se ata e vazhduan marrëdhënien e punës pas konfliktit, përkundrazi, ata pranuan se nuk kanë punuar për shkaqe sigurie.

Trupi Gjykses kishte bazuar përfundimin e vet për ankesat e këtyre dy ish punëtorëve në pretendimet e tyre se ata janë detyruar të largohen nga Kosova për shkaqe sigurie për përkatësinë e tyre etnike dhe në kthimin e barrës së provës pasi që Ankuesit pretenduan diskriminimin dhe paraqitën fakte nga të cilat mund të supozohet diskriminimi.

Që të dy Ankuesit paraqitën prova për të dëshmuar marrëdhënien e tyre të punës në NSH. Librezat e punës janë ende të hapura. Ankuesit pretenduan në ankesat e tyre se ata nuk mundën të punojnë pas konfliktit për shkaqe sigurie. Ata e përsëritën këtë argument gjatë seancës dëgjimore dhe në mënyrë eksplicite iu referuan situatës në Kosovë pas konfliktit dhe paraqitën prova se

ishin persona të zhvendosur që do të thotë se ata jo vetëm që pretenduan diskriminimin por paraqitën edhe fakte nga të cilat mund të supozohet diskriminimi në bazë të nenit 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit 2004/3. Prandaj, ishte AKP-ja ajo që duhej të dëshmonte se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Argumenti i Apeluesit 1 që Ankuesit duhet të kishin paraqitur prova nuk mund të zbatohet për shkak të formulimit të qartë të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit dhe qëllimit të ligjvënësisë. Ligji nuk kërkon që Ankuesit të provojnë se ka pasur diskriminim. Ai vetëm kërkon që Ankuesit të paraqesin fakte përmes të cilave mund të supozohet diskriminimi. Ata e bënë një gjë të tillë pasi që iu referuan rrethanave në Kosovë në vitin 1999 dhe pas konfliktit. Këto probleme të sigurisë madje u konfirmuan nga dëshmitarët e paraqitur nga AKP-ja. Prandaj, përfundimi i Trupit Gjykses për atë se atëherë kur ankuesit i paraqitën faktet nga të cilat mund të supozohet diskriminimi, barra e provës ishte mbi AKP-në, si i Paditur, është i saktë. AKP-ja nuk dha ndonjë provë për këtë në kuptim të nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, nëse Ankuesit ~~Shpendi Rrahmani~~ dhe ~~Alija Ahmeti~~ nuk do të ishin diskriminuar, ata do të ishin të regjistruar si punëtorë të NSH-së në kohën e privatizimit dhe do të ishin në listën e pagave për jo më pak se tri vite siç kërkohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13. Kolegji i Ankesave konsideron se vlerësimi i Trupit Gjykses në lidhje me këtë është i saktë duhet të vërtetohet.

Meritat e ankesës së Apeluesit 1 Skender Stublla

Trupi Gjykses me pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar e refuzoi ankesën e ~~Shpendi Rrahmani~~ si të pa bazuar, me arsyetim se ankuesi kishte ndërprerë punësimin e tij në NSH më 14 gusht 1997, pastaj i njëjti ishte shpallur invalid i kategorisë së parë si pasojë e sëmundjes, ndërsa nga data 3 prill 2003 ka marrë pension 35 euro. Në anën tjetër, Trupi Gjykses paraqiti argumentin tjetër se që nga data 3 prill 2003 ankuesi ka marrë pension 35 euro dhe kjo mbështet me Vendimin mbi aplikimin për pension bazë të datës 24 prill 2003, dhe në deklaratat e dëshmitarëve.

Kështu, Trupi Gjykses erdhi në përfundim se ai nuk i plotësoi kërkesat ligjore në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar, për tu përfshirë në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta legjitime.

Kolegji i Ankesave vjen në përfundim se Trupi Gjykses saktësisht ka zbatuar ligjin dhe ka vlerësuar faktet. Trupi Gjykses nuk e ka bazuar vendimin e vet vetëm në deklaratat e dëshmitarëve. Janë privat dokumentuese të mbledhura dhe të vlerësuara nga Trupi Gjykses për pensionimin e Apeluesit 1. Kryesisht, në parashtresën e tij të datës 23 shkurt 1998 që i ishte adresuar NSH-së ku kërkonte të ardhurat personale për vitet 1995-1996, Apeluesi 1 vetë kishte shprehur se ishte pensionuar në vitin 1998. Për më tepër, një kopje e vendimit të lëshuar nga NSH-ja Stacioni Bujqësor, më 11 shkurt 1998, i referohet qartë Vendimit NO.P oo5234 të datës 6 janar 1998, të lëshuar nga Fondi Republikan për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Punëtorëve dhe vërtetën se marrëdhënia e punës së punëtorit kishte përfunduar më 13 gusht 1997 për shkak të pensionimit invalidor. Megjithatë, ekziston edhe një vendim tjetër mbi Aplikimin për Pension Bazë të Apeluesit 1 ku atij i pranohet pensioni që nga data 3.4.2003. Për këtë arsye, nuk është e mundur të vërtetohen argumentet e Apeluesit 1 se aktgjykimi i Trupit Gjykses ishte i bazuar në deklaratat e dëshmitarëve. Deklaratat e dëshmitarëve vetëm se i kanë plotësuar provat dokumentuese përmes të cilave ishte vërtetuar se pensionimi i Apeluesit 1 kishte ndodhur para datës së privatizimit të NSH-së. Prandaj, ai as nuk ishte në listën e pagave në kohën e privatizimit e as nuk vjen ky fakt nga ndonjë lloj diskriminimi që mund ti jetë bërë atij siç parashihet me Ligjin Kundër Diskriminimit.

Sidoqoftë, as gjatë procedurës së shkallës së parë Apeluesi 1 nuk pretendoi të jetë diskriminuar kur i kishte përfunduar marrëdhënia e tij e punës. Prandaj, pretendimi i tij mbi atë se është shkelur parimi i trajtimit të barabartë në mes të palëve nuk është i saktë. Arsyeja e përfundimit të marrëdhënies së tij të punës nuk është e njëjtë sikur e të dy Ankuesve ankesat e të cilëve ishin konsideruar të bazuara nga Trupi Gjykses. Ajo çfarë e bën të dallojë në mes të pozicioneve të tre Ankuesve është fakti se për këta dy Ankuesit të cilët ishin përfshirë në listë, ekzistonte mundësia që atë të kishin qenë duke punuar në NSH në kohën e privatizimit nëse nuk do të ishin diskriminuar. Ankuesit që ishin përfshirë në listë pretenduan diskriminimin sa i përket përfundimit të marrëdhënies së tyre të punës në NSH për shkaqe sigurie për përkatësinë e tyre etnike. Kjo nuk qëndron për Apeluesin 1 i cili u detyrua të pensionohej për shkak të invaliditetit të tij madje përpara konfliktit. Ai nuk pretendoi ndonjë lloj diskriminimi lidhur me shpalljen e tij si invalid.

Përfundim

Nga arsyet e cekura më lartë, Kolegji i Ankesave vjen në përfundim se Trupi Gjykses saktësisht i ka vlerësuar faktet e ka interpretuar se mbi kë ishte barra e provës dhe ka zbatuar ligjin për lëndën në fjalë. Aktvendimi i Trupit Gjykses duhet të vërtetohet. Prandaj, në bazë të nenit 65(a) dhe (c) të UA-së së UNMIK-ut 2008/6 u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet/taksat gjyqësore:

Sipas Rregullave Plotësuese Procedurale të DHPGJS-së lidhur me Tarifat Gjyqësore, procedurat në lëndët që kanë të bëjnë me listat e punëtorëve me të drejtë legjitime (neni 67 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 dhe procedurat përkatëse ankimore), janë pa pagesë.

U vendos nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, më 5 korrik 2012.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

Nënshkrimi

Piero Leanza, Gjyqtar
EULEX

Nënshkrimi

Esmat Erterzi, Gjyqtare
EULEX

Nënshkrimi

Ondrej Pridal, Gjyqtar
EULEX

Nënshkrimi

Behxhet Muqiqi, Gjyqtar

Nënshkrimi